

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

09.07.2024

Ora 16:30

***RENDI i DITËS***

**Projektvendimi “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**


- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar (online)**
- **Helga VUKAJ Anëtar (online)**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Znj. M. Çelmeta, znj.M. Koja, z.E. Meta.**

**Parti Politike: P S (z. E. Salianji)**

**Të tjerë: KRIIK**

**Znj. I. Nano:** Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm fizikisht, tre anëtarë të Komisionit Rregullator dhe janë të pranishëm online dy anëtarë të komisionit, zonja Vukaj dhe zoti Çaka. Teknikisht jemi në rregull me anëtarët që janë online. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi një projektakt “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen në datë 4 gusht 2024”. Në mbledhje janë të pranishëm Sekretari i

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dy drejtorë të drejtorive të ligjshmërisë dhe komisioneve zgjedhore, përfaqësues të partive politike, përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë të tjerë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e projektaktit, më duhet të pyes anëtarët e komisionit nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Kolegë, zonja Vukaj, zoti Çaka, keni jashtë rendit të ditës ndonjë çështje? Nuk keni. Atëherë, fillojmë me çështjen e vetme që kemi në rendin e ditës. Projektvendimi është propozuar.., është përgatitur nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do t'ju lutesha zonja Çelmeta një prezantim të shkurtër.

**Znj. M. Çelmeta:** Përshëndetje zonja Nano! Përshëndetje të nderuar anëtarë, fillojmë me relacionin për projektvendimin “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”. Fillojmë me pjesën e parë të relacionit: Vlerësimi i ligjshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi. Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 244, datë 5.7.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë”, ka vënë në lëvizje Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë. Në vijim të dekretimit të zgjedhjeve, dhe në zbatim të nenit 20, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje, Komisioneri vlerëson se ky projektvendim është në kompetencën e Komisionit Rregullator. Në vijim të pjesës

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

së dytë e cila është një përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektvendimit do të vijojë të relatojë zonja Koja që është Drejtoreshë e Drejtorisë së Ligjshmërisë.


**Znj. I. Nano:** Po zonja Koja!

**Znj. M. Koja:** Faleminderit! Atëherë sikundër referoi zonja Çelmeta unë do të vijoj me përmbledhjen shpjeguese të projektaktit. Në zbatim të detyrimeve të ligjit të Kodit Zgjedhor, në këtë projektvendim parashikohen të gjitha afatet proceduriale të cilat janë të reduktuara në kohë dhe respektojnë kronologjinë e veprimeve të cilat parashikohen nga Kodi Zgjedhor, siç janë:

- kohëzgjatja e fushatës zgjedhore;
- detyrimi për raportimin e institucionit për veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë;
- monitorimi i OSHMA-ve nga Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- regjistrimi i subjekteve zgjedhore;
- përcaktimi i afatit për subjektet zgjedhore për paraqitjen e propozimeve për anëtarë të KQV dhe GNV;
- afati për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore dhe të organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe
- publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore.

Fushata zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë është parashikuar të fillojë më datë 26 korrik 2024, duke u garantuar kohë të mjaftueshme subjekteve zgjedhore për të shpалosur programet e tyre. Referuar nenit 77 të Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore fillon 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve. Duke qenë se afati 30 ditor nga dekretimi është shumë i ngushtë, kohëzgjatja e fushatës zgjedhore prej 9 ditësh kushtëzohet nga afati

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

i krijimit të KZAZ-ve, regjistrimit të subjekteve zgjedhore, komiteteve nismëtare, koalicioneve dhe kandidatëve. Po i kaloj një nga një shpjegimet dhe referimet për çdo afat të përcaktuar. Në referim të parashikimeve të nenit 59, pika 1 të Kodit Zgjedhor, në rastin e zgjedhjeve të pjesshme apo të parakohshme, Zyra e Gjendjes Civile në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, harton listën e zgjedhësve jo më vonë se 5 ditë nga nxjerrja e dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve. Referuar datës së Dekretit, afati për të hartuar listën është parashikuar jo më vonë se data 10 korrik 2024. Neni 92 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi 9 i Komisionit Rregullator parashikojnë detyrimin e institucioneve publike qendrore dhe vendore agjencive të tjerë për të raportuar të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Afati procedural në këtë rast është i reduktuar në kohë dhe kushtëzon datën 15 korrik 2024 si fillimin e detyrimit të Bashkisë Himarë, institucioneve të saj të varësisë dhe institucioneve publike qendrore, organeve të tyre të varësisë dhe degëve të tyre vendore, dhe agjensive ose ndërmarrjeve shtetërore, për të raportuar në KQZ, veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë nga data 15 korrik 2024 deri ditën e zgjedhjeve. Për shkak të afateve procedurale të reduktuara në kohë, raportimi duhet të kryhet jo më vonë se tre ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Në të njëjtën datë fillon edhe monitorimi nga Autoriteti i Mediave Audiovizive i OSHMA-ve për veprimtaritë me karakter publik të institucioneve publike. Neni 62, pika 5 i Kodit Zgjedhor parashikon se kryetari i njësisë së qeverisjes vendore cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve. Për shkak të afateve ligjore shumë të ngushta, Kryetari i Bashkisë në detyrë kushtëzohet të paraqesë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, listën e plotë të objekteve të qendrave të votimit që përmbushin kushtet e parashikuara në ligj, jo

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

më vonë se data 12 korrik 2024. Në të njëjtën datë, Prefekti i Qarkut Vlorë kushtëzohet të paraqesë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, listën e plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut që përmbushin kushtet e parashikuara në ligj për Vendin e Numërimit të Votave. Referuar nenit 79, pika 1 të Kodit Zgjedhor, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Duke qenë se afati 30 ditor nga dekretimi i zgjedhjeve është shumë i ngushtë, Kryetarit të Bashkisë në detyrë i lind detyrimi të përcaktojë vendet publike, në territorin e Bashkisë Himarë, për afishimin nga subjektet zgjedhore të materialeve propagandistike, jo më vonë se data 17 korrik 2024. Për shkak të afateve procedurale të reduktuara në kohë, si vijon përcaktohen afatet për paraqitjen e propozimeve për anëtarë në KZAZ, KQV dhe GNV, si dhe afatet për paraqitjen e kërkesave për regjistrim për subjektet zgjedhore:

Konkretisht, neni 29, pika 6 i Kodit Zgjedhor parashikon se në rast të zgjedhjeve të pjesshme KZAZ ngrihet jo më vonë se 10 ditë nga data e nxjerrjes së Dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve. Duke qenë se Kodi ka përcaktuar afat për Komisionerin për ngritjen e KZAZ, por nuk ka përcaktuar një afat për subjektet zgjedhore për të dorëzuar kandidaturat për anëtarë dhe sekretar, Komisioni Rregullator duhet të caktojë një afat të tillë. Data e parashikuar nga administrata për miratimin dhe konstituimin e KZAZ-ve është ndërmjet datave 12-13 korrik. Në projektvendim parashikohet se, për partitë politike të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë dhe sekretar në KZAZ, duhet të sjellin propozimet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, jo më vonë se data 11 korrik 2024. Neni 36, pika 2, i Kodit Zgjedhor, parashikon se “në rastin e zgjedhjeve të pjesshme, KZAZ-ja emëron anëtarët e KQV-së jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve”. Duke qenë se ligji nuk ka një


*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

afat për paraqitjen e propozimeve e kandidaturave për anëtarë në KQV, është përcaktuar se ato duhet të paraqiten nga partitë politike të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në KZAZ, jo më vonë se data 15 korrik 2024 ndërsa KZAZ-ja i miraton jo më vonë se data 20 Korrik. Neni 95, pika 1 i Kodit Zgjedhor parashikon se GNV caktohen 10 ditë para ditës së votimit, ndërsa propozimet për emërimin e anëtarëve dorëzohen në KZAZ të paktën 12 ditë para datës së zgjedhjeve. Projektvendimi, në zbatim të kësaj dispozite ka përcaktuar se partitë politike të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në GNV duhet t'i depozitojnë kandidaturat në KZAZ, jo më vonë se data 23 korrik 2024, ndërsa KZAZ i miraton jo më vonë se data 25 korrik. Nenet 64 e në vijim të Kodit Zgjedhor të cilët përcaktojnë rregullat dhe afatet për regjistrimin e partive politike dhe komiteteve nismëtare si subjekte zgjedhore, të koalicioneve dhe kandidatëve, nuk kanë përcaktuar afate për zgjedhjet e pjesshme. Në këtë kontekst, janë përcaktuar këto afate: Kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë duhet të paraqitet në KQZ nga partitë politike, jo më vonë se data 15 korrik 2024. Janë dhe afatet e ndërmjetme pra KQZ-ja kthen për plotësim dokumentacionin brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga dorëzimi. Partitë politike paraqesin dokumentacionin e korrigjuar brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga kthimi për plotësim. Në përfundim Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton kërkesat për regjistrim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga ridërgimi i dokumentacionit. Në të njëjtën datë, 15 Korrik, paraqesin në KZAZ kërkesën për regjistrim për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë, edhe Komitetet Nismëtare. Koalicionet zgjedhore duhet të paraqesin në KQZ, kërkesën për regjistrimin si koalicion, jo më vonë se data 19 korrik 2024. Dokumentet e kandidimit paraqiten në KZAZ, jo më vonë se data 22 korrik 2024. Edhe këtu kemi afate të ndërmjetme KZAZ-ja bën verifikimin e tyre, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga paraqitja, dhe në rast se vëren parregullsi, i

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

kthen për plotësim. Dokumentet e plotësuar duhet të riparohet jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë. KZAZ-ja merr vendim jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga riparohetja e tyre. Në referim të nenit 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor, është parashikuar që kërkesa për akreditimin e vëzhguesve shqiptarë dhe për vëzhguesit e huaj paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se data 1 gusht 2024. Neni 78, pika 4 të Kodit Zgjedhor, parashikon ndalimin e publikimit të sondazheve zgjedhore gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit. Në projektvendim, rezultatet e sondazheve zgjedhore kushtëzohen të mos publikohen gjatë 3 (tre) ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit. Për sa më lart, në këtë relacion Komisioneri nëpërmjet administratës së KQZ-së i propozon Komisionit Rregullator shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit. Ju falenderoj!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Koja, kemi ndonjë pyetje për relatimin e zonjës Koja dhe zonjës Çelmeta? Po, zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit! Së pari, një pyetje paraprakisht, në momentin që na është bërë kërkesa e Komisionerit Shtetëror për thirrjen e kësaj mbledhje, ne kemi kërkuar që ai të ishte prezent të paktën unë dhe kolegja ime Vukaj. A ka dijeni Komisioneri Shtetëror për këtë kërkesë tonën? Ja kemi nisur dhe atij me email.

**Znj. I. Nano:** Ia kam nisur dhe unë me email në njoftimin e djeshëm.

**Z. M. Çakaj:** Pra, ka dijeni dhe nuk ka denjuar të vijë këtu. Kështu rezulton.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

**Znj. M. Koja:** Komisioneri ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm.


**Z. M. Çakaj:** E kemi autorizimin këtu?

**Znj. M. Koja:** Është në rregulloren e funksionimit të Komisionit Rregullator.

**Z. M. Çakaj:** Kemi kërkuar të ishte personalisht prezent. Kjo natyrë vendimi vjen si pasojë e një vendimmarrje të mëparshme të Komisionerit, i cili ka çelur siparin e këtyre zgjedhjeve, kështu që do të donim të kishim një përgjigje të drejtpërdrejtë nga ai. Nëse ju e keni atë përgjigje në rregull. Personalisht do të preferoja të ishte ai personalisht.

**Znj. I. Nano:** Lidhur me këtë, sikundër e keni vënë re dhe në kërkesën tuaj është përcjellë me email, edhe në thirrjen që unë kam njoftuar në mbledhjen e Komisionit Rregullator është vënë në dijeni Komisioneri. Në çdo rast, unë do të thoja pa ditur pse, apo si e ka vlerësuar Komisioneri këtë gjë, unë mendoj që ne mund të therrasim, le të themi sipas rregullores sonë zyrtarë të tjerë të administratës për të qenë të pranishëm dhe po ashtu në rregulloren tonë neni 17, pika 2 ne kemi vendosur që në fillim të veprimtarisë sonë që Komisioneri vetë, ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, prezanton projektaktin. Padyshim ne jemi 3 organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe asnjëra dhe as tjertra nuk mund të detyrojnë një organ tjetër të jetë prezent në mbledhje. Besoj mjafton njoftimi, nga ana jonë është bërë ajo që është menduar, ajo që është vlerësuar, pastaj mbetet në vlerësimin e Komisionerit mund të vijë në të gjitha mbledhjet, mund të vijë në një, mund të mos vijë në asnjë.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

**Z. M. Çakaj:** Qartë, qartë, por ne kemi kërkuar të ishte prezent, nuk kemi urdhëruar të ishte prezent.

**Znj. I. Nano:** Njoftimi është bërë nuk kam përgjigje për mospraninë.

**Z. M. Çakaj:** Nuk ka denjuar të vijë, faleminderit! E dyta, zonja Çelmeta në cilësinë e Sekretares së Përgjithshme të komanduar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e konfirmoni që vendimi i Komisionerit nr. 69 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, zotit Dhionisios Alfred Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 Maj 2023” është marrë në datën 5 korrik? E konfirmoni këtë gjë?

**Znj. M. Çelmeta:** Unë mund të konfirmoj vetëm këtë gjë, që pyetja juaj është jashtë objektit të kësaj seance.


**Z. M. Çakaj:** Nuk ju takon juve të vlerësoni a është jashtë, apo brenda, se kjo ka lidhje me këtë. E konfirmoni vendimnarrjen apo jo? Kur është marrë vendimi nr. 69 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve?

**Znj. I. Nano:** Ta verifikojmë!

**Z. M. Çakaj:** Nëse nuk e keni këtë informacion mund të përgjigjet..

**Znj. I. Nano:** Në faqen zyrtare besoj se duhet të jetë.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

**Z. M. Çakaj:** Në faqen zyrtare më rezulton, por dua konfirmimin nga ana juaj.

**Znj. I. Nano:** Mund të bëni pyetje tjetër ndërkohë që verifikohet kjo?

**Z. M. Çakaj:** Pyetja tjetër është e lidhur me këtë.

**Znj. M. Çelmeta:** Deri sa ta verifikojmë, vetëm një moment të lutem dhe do t'ju kthej unë përgjigje. Atëherë nga kontrolli në faqen zyrtare elektronike të KQZ-së, më rezulton që është shpallur vendimi “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, zotit Dhionisios Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë” për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 Maj 2023”. Vendimi është nr. 69 i datës 05.07.2024 në orën 10:30.

**Z. M. Çakaj:** Pra, në datën 5 korrik është marrë vendimi i Komisionerit. Unë këtu kam një dokument të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku përcaktohet data e zgjedhjeve 4 Gusht 2024. Ky dokument është nxjerrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në datën 4 korrik. Pra, Komisioneri në datën 5 korrik ka marrë një vendim të cilin tashmë e dinte, që në datën 4 gusht do të zhvilloheshin zgjedhje. Pra, 30 ditë më vonë dhe e gjitha çfarë është bërë këtu i bie që të ketë qenë një teatër një shfaqje në sinkron edhe me Këshillin e Ministrave, me sa duket edhe me Presidentin. Pra, kemi të bëjmë me veprime fiktive, këtë konstatoj unë. Ky është dokumenti, ju është shpërndarë ju, në sistemin tuaj të brendshëm dhe përcaktohet data e zgjedhjeve. As hamendësim jo, data e zgjedhjeve 4 gusht 2024. Kaq i sigurt ishte Komisioneri që në datën 4 gusht 2024 do të zhvilloheshin zgjedhjet në Bashkinë Himarë?

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

**Znj. M. Çelmeta:** Mesa shoh ai nuk është një dokument zyrtar por është një exel që ne e zhvillojmë në çdo zgjedhje dhe vendosim data hipotetike. Ajo datë është thjesht një datë hipotetike, e cila ne na vë në lëvizje që të përgatitemi paraprakisht.

**Z. M. Çakaj:** Është pak e çuditshme, lexon datën 4 gusht dhe nuk thotë datë hipotetike, data e zgjedhjeve në Bashkinë Himarë 4 gusht.

**Znj. M. Çelmeta:** Nuk është dokument është një exel që ne e përdorim.

**Z. M. Çakaj:** Nuk thashë dokument zyrtar, kam një dokument që ka qarkulluar brenda Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Znj. M. Çelmeta:** Ai dokument nuk shërben si provë.

**Z. M. Çakaj:** Megjithatë, kaq pyetje kisha.

**Znj. I. Nano:** Kjo nuk është çështje që ka lidhje me aktin që po shqyrtojmë. Unë prandaj ju pyeta, të nderuar kolegë, në fillim të mbledhjes. Nëse keni çështje jashtë rendit të ditës? Kjo do të ishte çështje jashtë rendit të ditës dhe sikundër ne e përcaktojmë rradhën e diskutimit të çështjeve jashtë rendit të ditës, ose në fillim, ose në fund të diskutimit. Ka pyetje të tjera lidhur me relacionin e paraqitur nga administrata? Nëse jo çelim diskutimin në parim. Në këtë fazë e kanë anëtarët e Komisionit Rregullator, më tej përfaqësues të partive politike dhe të shoqërisë civile. Kolegë në parim kush ka për të diskutuar në lidhje me projektaktin? Po zoti Çakaj!


*Zbardhi materialin audio  
Valbona BKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

**Z. M. Çakaj:** Lidhur me aktin që është sjellë përpara Komisionit Rregullator për diskutim dhe miratim “Për përcaktimin e disa afateve proceduriale për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar së Bashkisë Himarë, që do të zhvillohen në datën 4 Gusht 2024”. Siç e theksova dhe më parë sigurisht dhe pasi ma konfirmuan Sekretarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Mua personalisht, më rezulton që akti inicues që ka çelur siparin edhe të njoftimit të Këshillit të Ministrave, edhe Dekretit të Presidentit më rezulton që, nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të jetë marrë në kapërcim, madje në mungesë të kompetencës së tij për të shqyrtuar pavlefshmërinë e mandatit aposteriori për një kandidat. Pra, baza ligjore e përdorur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është Ligji për Dekriminalizimin. Ndërkohë që Ligji për Dekriminalizimin bën fjalë qartazi për ngjarje ose situata juridike të cilat do të duhet të kenë ndodhur përpara kandidimit dhe kandidati për Bashkinë Himarë, ose nuk i ka bërë të ditura, ose ka qenë në kushtet e ndalimit. E gjithë vendimmarrja e mëpasshme në gjykimin dhe vlerësimin tim personal është thjesht dhe vetëm absolutisht e pavlefshme. Pra, personalisht akti që ka inicuar këtë proces në gjykimin dhe vlerësimin tim, fare mirë, mund të konsiderohet një akt absolutisht i pavlefshëm. Pavarësisht kësaj edhe në hipotezën se ky akt do të vlerësohet nga organet kompetente siç janë gjykatat, në pikën 3 të këtij akti, ne konsiderojmë dhe kemi të parashikuar që ndaj këtij akti mund të bëhet ankimi në gjykatë brenda 30 ditëve. Por çfarë ka ndodhur? Po ditën që është ndërmarrë akti i Komisionerit, kemi një vendimmarrje nga ato vendimmarrjet, disa vendime në një ditë. Me një shpejtësi të rrufeshme janë vënë të gjithë institucionet më të larta në këtë vend dhe kanë caktuar datën, tashmë mesa duket ishte e paracaktuar, datën 4 gusht si datë për zhvillimin e zgjedhjeve në Himarë. Kështu që, unë gjykoj që akti që ka paraprirë gjithë këtij procesi është abosulitisht i pavlefshëm dhe të gjithë pasojat e tij në vlerësimin e gjykimin tim personal nuk qëndrojnë. Pavarësisht kësaj nuk është respektuar as afati

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

30 ditor, pra një nga garancitë dhe parimet kryesore të shtetit të së drejtës, është e drejta e ankimit. Askush nuk mund të dënohet apo të konsiderohet i gjykuar pa një vendim të formës së prerë. Unë nuk e di dhe nuk e gjej asgjëkundi që vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve apo vendimi i çdo organi drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është një vendim që përbën titull ekzekutiv. Megjithatë është fakt i njohur publik, që ne kemi një ankim dhe eventualisht kërkesën për marrjen e masës së sigurimit ndaj dekretit të Presidentit. Kështu që, gjykoj dhe vlerësoj se ne duhet të presim vendimmarrje nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, përpara se të kalojmë në çfarë do lloj vendimmarrje të miratimit të këtij akti. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Zoti Çakaj, do të doja të theksoja dhe një herë, para nesh anëtarëve të Rregullatorit dhe të pranishmëve, ne nuk jemi këtu për të vlerësuar një vendim të Komisionerit. Në rast se do të ketë ankim është një organ tjetër drejtues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve ai që vlerëson mbi bazë ankimi vendimmarrjen. Pra, së pari, lidhur me vendimin e Komisionerit ka një organ tjetër që e shqyrton është KAS-i, nuk jemi ne. Së dyti, lidhur me Dekretin e Presidentit, edhe unë kam dëgjuar në lajme që është paraqitur një kërkesë në gjykatë. Në momentin që çështja është në gjykatë, nuk mundet të diskutojmë është apo nuk është i pavlefshëm? Ka parashikime ligjore në Kodin e Procedurës Civile që është dhe një lloj ligji plotësues për ligjin për gjykatat administrative. Ne sot jemi për të shqyrtuar një projektakt që vjen me propozim të Komisionerit, i përgatitur nga administrata për afate procedurale. Është një akt që është në kompetencën e Komisionit Rregullator dhe kjo tashmë është provuar në më tepër se një palë zgjedhje të pjesshme. Kemi ndonjë gjë për kompetencën është apo nuk është në kompetencën tonë akti?

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

**Z. M. Çakaj:** A mund të lidhet edhe kolegja se nuk më rezulton, atëherë ta pezullojmë të jemi të pestë në vendimmarrje.

**Znj. I. Nano:** Po zonja Vukaj dëgjolesh.


**Znj. H. Vukaj:** Nuk kam dëgjuar asgjë se çfarë është zhvilluar në mbledhje. Kam ndërprerë dëgjimin në momentin kur zoti Çakaj mori fjalën dhe kërkoi verifikimin e vendimit të Komisionerit. Nuk di se çfarë ka ndodhur më tutje. Kështu që ose një përditësim ose në qoftë se zoti Çakaj ka mbaruar kërkoj të marr fjalën.

**Znj. I. Nano:** Ta merrni ju fjalën apo ta marrë zoti Çakaj?

**Znj. H. Vukaj:** Nëse zoti Çakaj ka mbaruar dhe pasi të më bëhet një përditësim mundësisht se çfarë rezultoi, çfarë verifikoi administrata, në qoftë se biem në përsëritje po e zhvendos fjalën. Në qoftë se përsëri zoti Çakaj ka mbaruar kërkoj të marr fjalën.

**Znj. I. Nano:** Zoti Çakaj ka mbaruar fjalën, isha duke folur unë, sapo të mbaroj do t'ju jap fjalën zonja Vukaj, faleminderit! Pra, jemi duke diskutuar, ose të paktën zoti Çakaj foli për vendimin e Komisionerit nr. 69 dhe dekretin e Presidentit. Unë tashmë kam kaluar në diskutimet mbi aktin, mbi faktin që ne jemi kompetentë për aktin. Kjo gjë është provuar edhe në zgjedhje të tjera të pjesshme. Në zgjedhjet e pjesshme të datës 24 Shtator për Kryetarin e Bashkisë Kukës në vitin 2023 dhe në zgjedhjet e pjesshme për 6 kryetarë bashkie të datës 6 Mars 2022. Të njejtat situata kemi pasur edhe në këto dy zgjedhje të shkuara, ku na është dashur të miratojmë akte proceduriale për shkak se, vërtet Kodi Zgjedhor parashikon mundësinë e dekretimit

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

e zgjedhjeve nga 30 në 45 ditë, por në të tre rastet kemi afate të ndryshme. Zonja Vukaj jam duke folur do t'ju jap fjalën sapo të mbaroj.

**Znj. H. Vukaj:** Kemi kushte jo të barabarta, kështu që, para se të kalojmë në vlerësimin e kompetencës kisha pyetje drejt administratës, që të krijojë panoramën e duhur nëse jemi në kushtet e legjitimitetit të kompetencës apo jo? Kështu që para se të futemi në akt, të lutem fjalën për të vijuar me pyetjen.

**Znj. I. Nano:** Në diskutim në parim jemi, atëherë pyetja juaj është për administratën. Po, zonja Koja, apo do të riformuloni pyetjen? Ju dëshironi fjalën? Fjalën e ka zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Të nderuar pjesmarrës në rrethanat e subjekteve që mund të kenë interes, kolegë gjithashtu të nderuar. Përpara se të kalojmë në shqyrtim apo në vlerësim të draftit të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili në këtë rast është në cilësinë e propozuesit, në respekt të parimeve dhe të drejtës dhe transparencës, unë personalisht ndjej obligimin të sjell panoramën perceptuese paraprake të këtij drafti. Por, do të doja të shoqëroja dy tre pyetje të shkurtra në lidhje me zonjën Çelmeta ose Koja kush të jetë disponibël. Pyetjen e parë e kam me zonjën Çelmeta meqenëse është në rolin hierarkik administrativ më të lartë aty dhe zëvendëson si të thuash me delegim, apo autorizim Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Cili është legjitimiteti i zëvendësimit në këtë rast sot? Pra, me çfarë atributi u ka deleguar Komisioneri prezencën në vend të tij, në momentin kur ne kërkojmë domosdoshmërisht prezencën e tij? Sepse nuk jemi në kushtet apo rrethanat e një procesi përvijues administrativ, apo veprimesh administrative. Në rastin tonë kryhen veprime administrative dhe proces administrativ vijues ku të kemi

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

një qartësi, apo të kemi jo pengesa si në rastin e situatës aktuale, apo të këtij drafti të propozuar. Pra, cila është arsyeja që legjitimojmë mos prezencën kur dy anëtarë e kërkojnë me domosdoshmëri dhe rezulton që zoti Komisioner paska marrë dijeni. Së dyti, për zonjën Koja, a është ky një proces përvijues mbi bazën e një akti i cili ka dalë pas zhvillimit të një procedimi administrativ?

**Znj. M. Çelmeta:** Atëherë për zonjën Vukaj, në lidhje me prezencën apo jo të zotit Celibashi, mendoj se nuk ka përgjigje për pyetjen tuaj.

**Znj. H. Vukaj:** Keni ndonjë autorizim ku ju ka përligjur? Jeni prezent ta zëvendësoni në këtë rast pasi ne e kemi thirrur, pra tregon që është domosdoshmëri.

**Znj. M. Çelmeta:** Prezenca ime këtu për të relatuar është në zbatim të rregullores së KQZ-së.

**Znj. H. Vukaj:** Rregullorja e KQZ-së zonjë, ju jep mundësinë e mjetit zëvendësues, pra duhet ai vetë thotë rregullorja, e më pas ju. Në qoftë se ne do ta kërkonim, apo do të ishim në kushte të zakonshme.

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj, mundem ju lutem, se ndoshta nuk e keni ndjekur diskutimin më herët për shkak të problemeve teknike?

**Znj. H. Vukaj:** Më përditësuat ju dhe aq e ndoqa sa për të krijuar perceptimin. Mos më ndërprisni kur unë kam fjalën, sepse nuk të lejon rregullorja e nderuar. Zonja Koja më thuaj ky procesi sotshëm, a është në vazhden e përvijimit të procedimit hetimor administrativ të ndjekur më parë me aktin që ju prezantuat 69, datë

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

05.07.2024, për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë?

**Znj. M. Koja:** Faleminderit për pyetjen zonja Vukaj! Atëherë pyetja juaj është a është ky proces përvijues? Procesi i shqyrtimit të këtij projektvendimi sot, lind si një detyrim pas dekretimit të zgjedhjeve nga ana e Presidentit....

**Znj. H. Vukaj:** Zonjë ju lutem, e kam prezent dekretin i cili vjen si pasojë e procesit administrativ. Ju pyeta a e zhvilloi KSHZ-ja, një procedim administrativ me rastin e vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 po, apo jo?

**Znj. M. Koja:** Atëherë pyetja juaj ishte a është ky proces procesi që ne po...

**Znj. H. Vukaj:** Në vazhden e procedimit dhe veprimeve administrative? Po ju pyes ju si drejtoreshë juridike dhe njohëse e kuadrit ligjor rregullator.

**Znj. M. Koja:** Sot unë këtu jam në cilësinë e Drejtorit të Ligjshmërisë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të dhënë shpjegime teknike dhe shpjegime përtej atyre..

**Znj. H. Vukaj:** A keni zhvilluar një procedim administrativ...

**Znj. M. Koja:** A mund ta mbaroj fjalinë të lutem?

**Znj. H. Vukaj:** ...të çelë siparin e gjithë këtyre hallkave procedimore vendimmarrëse, në pritshmëri sigurisht.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

**Znj. M. Koja:** Atëherë, më lejoni ta çoj deri në fund atë që doja të thoja. Sot jam këtu në këtë proces që është procesi i shqyrtimit të një projektvendimi nga ana e Komisionit Rregullator, i propozuar nga Komisioneri dhe i hartuar nga administrata, i cili ka të bëjë me disa afate procedurale. Pse është hartuar ky akt, ky proces administrativ të cilët jemi të përfshirë të gjithë sot? Është se buron nga dekreti i Presidentit dhe kjo është përgjigja ime për pyetjen tuaj.

**Znj. H. Vukaj:** A është zhvilluar një procedim administrativ, apo ishte thjesht një veprim administrativ ai me rastin e vendimit nr. 69, datë 05.07.2024? po, apo jo? E thjeshtë!


**Znj. M. Koja:** Për sa i përket pyetjes tuaj, ajo është një pyetje që ndoshta duhet ta drejtonit diku tjetër. Unë sot jam e autorizuar të jap shpjegime vetëm për sa i përket këtij projektvendimi.

**Znj. H. Vukaj:** ... të të gjithë procesit vendimmarrës të organeve të KQZ-së. Pra, administrata e KQZ-së dhe Drejtoria Juridike i shërben të gjithë organeve. Unë në vazhden e një veprimtarie të ligjshme po ju pyes. A zhvilluat një procedim administrativ, apo kryet një veprim administrativ, zonjë e nderuar?

**Znj. M. Koja:** Për të dhënë përgjigje ndoshta duhet të angazhohen...Ndoshta ne flasim njëkohësisht dhe humbasim ndonjë fjalë të njëri tjetrit. Nëse keni mbaruar mund të vazhdoj.

**Znj. H. Vukaj:** Po pres përgjigje, zonja Koja.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*


**Znj. M. Koja:** Atëherë zonja Vukaj, në lidhje me pyetjen tuaj, në qoftë se doni një përgjigje të gjatë edhe më shteruese, atëherë do të ishte ndoshta e udhës që...

**Znj. H. Vukaj:** Po apo jo?

**Znj. M. Koja:** A mund ta jap përgjigjen se ndryshe nuk do të vazhdojmë gjithë kohës me ndërprerje të fjalës së njëri tjetrit. Do të duhej një përgjigje më e gjatë dhe nga strukturat e përfshira në procesin e shqyrtimit administrativ apo çdo gjë që ai mund të jetë. Kështu që ju lutem, unë sot, jua thashë dhe më lart, jam këtu për të dhënë të gjitha shpjegimet e nevojshme që kanë të bëjnë me këtë projektvendim që është në rendin e ditës. Për të tjerat kërkoj kohë të bashkërendoj edhe me strukturat e tjera që i kanë në fushë të përgjegjësisë së tyre për t'ju dhënë një përgjigje. Faleminderit!

**Znj. H. Vukaj:** Vetë procesi është i ngutshëm zonja Koja, demonstron aktiviteti dhe dinamika e gjithë këtyre akteve të cilat nuk kanë tharë bojën e njëra tjetrës. Por, gjithsesi unë jam e qartë në atë çfarë përshfaqet ose çfarë përmbajtje ka. Kështu që në meritë të këtij morali dhe transparencës unë do të vazhdoj dy fjalët e mia për të dhënë panoramën sqaruese aktorëve prezent aty, por dhe të interesuarve të tjerë. Ky draft vjen si rrjedhojë e veprimeve procedurale apo procedimore të kryera në kuadër të miratimit të aktit individual të Komisionerit nr. 69, datë 05.07.2024, ora 10:30 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë..”. Është një akt individual, i cili vjen si rrjedhojë e zhvillimit të procedimit administrativ dhe prezumohet në këtë rast të ruajë standartet e përmbajtjes pra, substanciale dhe procedurale dhe të formës njëkohësisht, që kërkon detyrimisht Kodi Zgjedhor, Kodi i Procedurave Administrative. Elementë të cilët i japin aktit sigurisht valencën dhe e kornizojnë atë për të qenë i ligjshëm, i paligjshëm ose i pavlefshëm. Siç rezulton

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

ky akt ende nuk e ka shteruar fazën e verifikimit të ligjshmërisë së tij, as përmes mjeteve të kontrollit të brendshëm dhe as përmes verifikimit të jashtëm të ligjshmërisë nga gjykata. Pra, ky akt është dhe mbetet ende i pakonsoliduar. Megjithatë në vazhden e kësaj panorame çfarë më spiskati dhe konstatova nga akti i propozuar sot, i cili pasi të kalojë për vlerësim dhe shqyrtim nga ana jonë në këtë mbledhje, unë do të doja të cekja nja dy pika të nderuar prezentë në sallë. KSHZ-ja, nxit vijimin e procesit zgjedhor me këtë akt tjetër i cili i është sjellë pra, Komisionit Rregullator me qëllim miratimin e afateve. Nga të cilat mua më bëri përshtypje afati i lënë Gjendjes Civile ose Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, ku marzhet janë të qarta dhe definojnë deri në 10 ditë. Ndërkohë që në akt na lihet marzhi maksimal. Ndërkohë ju kujtoj të nderuar, që ky organ është përshfaqur dhe është targetuar, apo raportuar nga subjektet e huaja ndërkombëtare që kanë të drejtën e raportimit dhe mediat si një subjekt, apo dhe nga raportet e audituesve si një institucion me risk. Si mund t'i lihet kaq kohë një institucioni të tillë, i cili ka demonstruar se nuk ka pasur integritet me listat e zgjedhësve. Atëherë, pse mos të vendosnim për këtë institucion afatin ngrirës atë të daljes së Dekretit të Republikës dhe me këtë rast zonja Çelmeta kërkoj që t'i dërgohet një kërkesë urgjente Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Gjendjes Civile përkatëse, të na pajisë menjëherë me listën elektronike fizike sido që ta kenë ata, në atë moment kur doli dekreti i Presidentit. Kështu që kjo është detyrë që do t'i shpërndahet njëkohësisht edhe subjekteve të interesuara, partive politike apo të tretëve që kanë interes për procesin, padyshim edhe ne si anëtarë, sepse na shërben si provë për procedimet e tjera. Po kështu, më ka bërë përshtypje edhe afati 15.07.2024 në kuadër të raportimit të veprimtarive të ndaluara, ku ju vendosni një nga pikat e rrjedhura që burojnë nga vendimi nr. 9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator. Si nuk u shkoi mendja të vendosni, ose në mënyrë të qartë dhe literale të bëni pjesë të draftit edhe ndalimet e

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

tjera dhe lejes së legalizimit, dhënie privilegjesh, dhënie ku di unë..., pra gjithshka që përmban akti nr. 9 i vitit 2020, por ndaleni vetëm tek raportimi. Këto ishin si pikënisje edhe pse ka plot elementë të tjerë për t'u diskutuar. Kjo është për konsolidim të vlerësimit në vijim dhe njëkohësisht edhe vënies së pikës, në kuadër të transparencës të pjesmarrësve të qytetarëve të interesuar në zonën ku do të zhvillohen këto zgjedhje. Faleminderit paraprakisht.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Vukaj! Po zonja Koja.

**Znj. M. Koja:** Nga pikëpamja teknike një sqarim mendoj që është i nevojshëm, vetë Kodi Zgjedhor në nenin 59 të tij ka...

**Znj. I. Nano:** Më fal, që po ju ndërpres nuk kemi filluar me nen për nen ishte një panoramë e përgjithshme që bëri zonja Vukaj. Kur të kalojmë nen për nen padyshim që mund të kemi edhe diskutime të tjera. Në parim partitë politike, shoqëritë civile keni diçka për të thënë para se të kalojmë në votim? Po zoti Salianji!

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Për sa i përket shqyrtimit të aktit, në fakt nuk do të merrja fjalën por meqenëse dëgjova diskutime dhe nga diskutimet vë re që ka rrëshqitur nga kompetenca që ka, ky Komision Rregullator, në arsyetimin ligjor që japin për sa i përket të drejtës dhe kompetencës së vet për të gjykuar. Së pari, kjo ka të bëjë me atë çfarë ne sot gjykojmë? Çfarë vendimmarrja i është paraprirë këtij Komisioni që ka të bëjë me llogaritjen e afateve dhe jemi komplet jashtë objektit, jashtë kompetencës që mund të gjykojmë një vendim të Komisionerit, i cili nuk gjykohet nga kjo trupë. Ligjvënësi ka përcaktuar një trupë tjetër e cila e gjykon, që është KAS-i dhe këtu jemi në tejkalim të kompetencave ne kufi të shpërdorimit. Pra,

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

në qoftë se ti do të marrësh kompetencat e një organi tjetër, atëherë je për ligjin ose qëllimisht e shpërdoron atë. Së dyti, se këtu po diskutojmë afate, diskutojmë të drejtën e këtij komisioni për të rregulluar proceduralisht organizimin e zgjedhjeve dhe jo atë që ka të bëjë me Ligjin e Dekriminalizimit. Është një organ që nuk ka punë fare me diskutimin për Ligjin e Dekriminalizimit, “zero”. Unë një pyetje kisha këtu për administratën. Cili është akti që ka vënë në lëvizje administratën e KQZ-së për të përgatitur këtë akt, është vendimi i Komisionerit apo është dekreti i Presidentit?

**Znj. M. Koja:** Sikundër është pasqyruar dhe në bazën ligjore të projektvendimit është Dekreti nr. 244, datë 05.07.2024 i Presidentit të Republikës.

**Z. E. Saliانji, përfaqësues i PS-së:** Faleminderit! Pra, baza dhe nisja e këtij procedimi administrativ nga Komisioni është detyrimi që sjell dekreti i Presidentit. Dekreti i Presidentit është një dekret i cili është një organ i cili nuk varet nga ky komision. Ky komision ka të drejtë vetëm të përcaktojë rregulla dhe afate, kalendarin e punës. Një organ..., ju sot jeni për të përcaktuar kalendarin sesi do të zhvillohen zgjedhjet me data përkatëse dhe unë vërej këtu që dhe nga diskutimet dhe nga pyetjet kërkohet që të futen në kompetencat e Presidentit të Republikës. Diskutohet dekreti! Ky diskutim mund të bëhet, por jo në këtë sallë, e bën gjykata. Diskutohet Ligji për Dekriminalizimin, i cili mund të bëhet në këtë sallë, por jo nga ky organ, i cili është KAS-i dhe për të dhënë opinione ligjore minimumi duhet të kishim lexuar vendimin e Komisionerit i cili si një vendim, me dhjetra vendime të tjera që janë dhënë për Ligjin e Dekriminalizimit, thotë në vendimmarrjen e tij që: ky vendim hyn në fuqi menjëherë! Kjo do të thotë që nga ky moment i ka lindur e drejta Presidentit të Republikës brenda 48 orëve, aq e ka afatin në zgjedhjet e pjeshme që të japë

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

dekretin për datën e zgjedhjeve. Është e drejtë, këtë vendim e gjykon KAS-i ose Gjykata. Kemi një dekret në fuqi, kemi kërkesë nga pala në gjykatë, por ne këtu nuk mund ta diskutojmë. Këtu ne do të diskutojmë atë çfarë ju kemi diskutuar për Kukësin. Është tamam në çdo presje, në çdo pikë ky projektakt si vendimmarrjet që ju keni marrë për Kukësin, ato afate janë lënë, ato afate janë llogaritur. Madje pashë për sa u përket institucioneve që ishte një shqetësim legalizime e të tjera, nuk është ky akt që i ndalon. Edhe në Kukës është e njëjta, ju keni qenë këtu dhe e keni miratuar. Pra e njëjta, raportimi atë çfarë thotë ligji për këto zgjedhje, subjektet duhet të raportojnë dhe ju përcaktoni kohën e raportimit dhe ajo çfarë parashikon ligji, ajo do të paraqitet në akt. Kurse për sa i përket afateve të tjera ju mund të diskutoni afatet këtu me ditë. Por, këtu nuk mund të diskutohet dekreti i Presidentit, nuk është kjo salla. Këtu nuk mund të diskutohet Ligji i Dekriminalizimit, vetëm në qoftë se ju keni vendosur që të pengoni zgjedhjet. Në Himarë nuk i pengoni dot zgjedhjet se zgjedhjet i bën ligji në fakt. Po ju them dhe këtë, po kuptoj nga debati këtu që bërja e këtij akti do të thotë që do të presim 30 ditë domethënë do të pengojmë zgjedhjet..., nuk pengohen zgjedhjet. Kjo që miratoni ju sot është kalendar zgjedhjet i bën Kodi Zgjedhor, zgjedhjet bëhet pas ligjit. Kjo është që ju të pengoni procesin, doni ju të pengoni procesin, por nuk është kjo rruga dhe nuk është ky momenti. Pengimi i procesit është në shkelje të ligjit që ju po i bëni sot, në qoftë se do të diskutoni afatet isha i gatshëm që të diskutojmë pse 5 ditë pse 10 ditë. Këtë keni kompetencë një afat që është vënë 7 ditë eja ta diskutojmë e doni më shumë? Por nuk mundet këtu të merrni një vendimmarrje që nuk ka lidhje me ju, ta hidhni në tavolinë dhe pastaj të thoni që këtu në parim kjo nuk është kompetencë. Prandaj ju ftoj që të vlerësoni dhe ta kaloni këtë akt për arsye se e kundërta ju me vendimmarrjen tuaj thjesht do të ishit në kufi të shpërdorimit të detyrës, se nuk janë shkaqet që ju ngritët që bëjnë këtë akt të mos miratohet. Ju kërkoni që të merrni kompetencat e organeve të tjera. Marrja e

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

kompetencave ju e kuptoni fare mirë, se jeni juristë të gjithë, se ku të çon. Prandaj ju them që të vlerësoni dhe një herë qëndrimin, ejani të diskutojmë për aktin, për afatet për ditët. Doni të fusni kontrolle të tjera, por jo se mund të miratohet ky akt për arsye se po gjykohet dekreti. Patjetër po gjykohet dekreti, është në gjykatë, ka kërkuar masë sigurimi, ju merrni vendimin sot, nesër merret një masë sigurimi, e ka përcaktuar ligji se çfarë ndodh por s'mundet që ju jashtë kompetencave të pengoni procesin zgjedhor se afatet janë shumë të shkurtra dhe nga kjo vendimmarrje varen afatet në lidhje me ecjen e procesit zgjedhor. Megjithatë ua thashë dhe ua rithem që zgjedhjet organizohen në bazë të Kodit Zgjedhor dhe nuk besoj se kjo vendimmarrja juaj mund të pengojë realizimin e zgjedhjeve në Himarë. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Nuk kemi arritur zoti Salianji ende në votimin e projektaktit, jemi në diskutimin në parim. Zoti Çakaj ju keni kërkuar fjalën, por nëse është e mundur ndërkohë ka qenë online zoti Çaka dhe nuk ka pasur mundësi, të mos bëjmë debat për këtë gjë.

**Z. M. Çakaj:** Për aktualitetin e gjësë... Unë besoj se është shumë e rëndësishme ajo çfarë tha zoti Salianji, këtu ishte intimidim, kërcënim dhe e ftoj që të ruajë qetësinë dhe ta përdorë jashtë kësaj salle. Na bën shumë përshtypje, së pari jeni të lirë të thoni çfarë do lloj gjëje nuk funksionon në këtë sallë.

**Znj. I. Nano:** Zoti Çakaj sa të drejtoj unë këtë mbledhje nuk do të lejoj askënd të intimidojë askënd.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

**Z. M. Çakaj:** Sapo e lejuat, sapo përmendi shpërdorim detyre, disa shprehje të kësaj natyre, unë e ftoj t'i thotë jashtë kësaj salle, jo në këtë sallë për etikë të kësaj vendimmarrje.

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj mos ndërprisni ju lutem fjalën e askujt.

**Z. M. Çakaj:** Atë shprehje, atë qasje është i lirë ta përdorë jashtë kësaj salle jo në këtë sallë, dakord? Nuk mund të përdorë shprehje intimiduese apo kërcënuese të tipit jeni në kufi të shpërdorimit të detyrës, po nuk ushtruat detyrën tuaj. Nëse ne ushtrojmë në përputhje apo jo me ligjin detyrën tonë, nëse ne e kapërcejmë kompetencën që në vlerësimin tim të brendshëm si puna e Komisionerit ka një organ tjetër që shprehet, jo ju i nderuar, së pari. Së dyti, unë sinqerisht më bën pak çudi sesi paskeni lëvizur ju nga qëndrimi ku në këtë sallë në vitin 2019 dhe unë nuk e kam guximin meqë jam jurist ta quaj nul dekretin e Presidentit, ju i nderuar keni mbështetur një ish kolegun tonë të asaj kohe që e kanë quajtur nul dekretin e Presidentit. Unë nuk e kam këtë guxim meqënëse jam jurist. Së treti, pikërisht se po verifikohet ligjshmëria ose minimalisht po kërkohet pezullimi i efekteve të dekretit në një gjykatë nëse nuk ishit i vëmendshëm e ripërsëris faktin që ky akt minimalisht është i nxituar do të duhet që brenda..., se ka afate procedurale gjykata administrative dhe ju si puna ime e dini brenda 5 ditëve merret vendimi për marrjen ose jo të masës së sigurimit dhe më pas mund të diskutojmë në përputhje dhe me ato konstatimet e zonjës Vukaj, miratimin e këtij akti dhe të diskutojmë pastaj për afatet. Nuk cënon njeri procesin zgjedhor por do të duhet që gjërat t'i marrin brenda ligjshmërisë dhe me rradhë. Së fundi, zoti Salianji sjell në vëmendjen tuaj se ne kemi 8 muaj që i kemi bërë me dije Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për uzurpim kompetencash dhe të gjithë ankesat dhe kërkesat tona kanë rënë në vesh të shurdhër. Ka disa vendime

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

të cilat janë të natyrës rregullatore dhe i takojnë këtij komisioni t'i miratojë dhe në kapërcim të kompetencës së parashikuar nga neni 20 e vijues i Kodit Zgjedhor dhe kompetencave të tjera dhe ligjshmërisë të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative, të cilat nuk janë marrë në konsideratë. Kështu që së pari, ju ftoj të ruani etikën, të flisni me një gjuhë dhe nuk e bën të ligjshëm apo të paligjshëm vendimmarrja jonë brenda tagrave të kompetencës, apo mënyra e arsytimit nuk konsumon elementët qoftë të shpërdorimit të detyrës apo elementë të tjerë. Kështu që, ju ftoj të reflektoni të jeni konsistent në qëndrimin tuaj kur e keni konsideruar nul dekretin e Presidentit dhe e ritheksoj dhe një herë që unë nuk e kam atë guxim juridik ta konsideroj nul por do të shprehet gjykata, që në vlerësimin tim ky akt administrativ individual është kompetencë e shprehjes nga gjykata, merret apo jo masë e sigurimit dhe më pas mund të diskutojmë, faleminderit.

**Znj. I. Nano:** Ju bëj thirrje të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator dhe të gjithë pjesëmarrësve në mbledhje të fokusohemi te projektakti që kemi për shqyrtim dhe miratim, jemi në fazën e diskutimit në parim të projektaktit. Ju kërkova të gjithëve të shpreheshit në parim për projektaktin, po për këtë projektakt, jo për çdo akt të miratuar në çdo periudhë kohore. Nuk bëjmë vështrimin historik të ngjarjeve në këtë moment. Zonja Koja u përgjigj më herët ne jemi vënë në lëvizje nga Komisioneri, ai e ka nisur këtë proces pas daljes së dekretit të Presidentit të Republikës, dekret i cili është në fuqi. Në qoftë se nesër pasnesër deri të premtën brenda afatit 5 ditor gjykata e pezullon zbatimin e dekretit, atëherë dhe ne do të ndërrmarim veprimet tona se pezullohen gjithë këto afate ose shtyhen. Por, në këtë moment dekreti është në fuqi. Pra, ne nuk mundet në mënyrë hipotetike të vlerësojmë çfarë mund të gjykojë dhe të vendosë gjykata nesër, pasnesër brenda 5 ditëve. Përndryshe ne nuk mund të bëjmë dot asnjë hap të presim çfarë ndodh me këtë, të presim çfarë ndodh

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*


me atë, ndërkohë ka një dekret që ka përcaktuar datën 4 gusht si datën e zgjedhjeve. Ka disa afate që burojnë nga ligji dhe janë përfshirë në këtë vendim, ka disa afate të tjera që ligji nuk i parashikon, por ne për shkak të kronologjisë së ngjarjeve çfarë duhet të ndodhë dhe kur duhet të ndodhë njëra pas tjetrës. Kemi një projektakt për ta diskutuar, nuk është fare çudi, ne kemi miratuar edhe dy akte të tilla. Unë e përmenda dhe më herët pse nuk kemi pasur kurrë këtë lloj diskutimi, nuk jemi ne që diskutojmë sot vlefshmërinë e dekretit të Presidentit? Ne sot kemi një dekret që kemi detyrimin ta zbatojmë është në fuqi, kaq. Zoti Salianji do t'ju lutesha, do t'ju jap fjalën por jo për të bërë debat dhe dua që zoti Çaka që ka kërkuar fjalën më herët, të marrë fjalën pas zotit Çaka, zonja Vukaj që të mbyllim diskutimet në parim për projektvendimin.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Nuk e di ku e pa zoti anëtar i Rregullatorit intimidimin! Nuk intimidova as nuk më shkon mendja të intimidoj, por thjesht unë konstatova duke dëgjuar raportimet, duke konstatuar që organet dhe në oqftë se...

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj, është duke folur zoti Salianji ju lutem.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Në qoftë se është keqkuptuar unë thashë thjesht që këto veprime se që të mos të zhvillohen zgjedhjet në një bashki e cila tashmë e dinë të gjithë që është pa kryetar bashkie, ka një vit dhe për shkak të këtij debati, një debat i cili tenton të bëhet juridik, por është jashtë kompetencave të kësaj sale. Normalisht që mua më shkon mendja dhe te shpërdorimi. Nuk e kisha për asnjërin prej jush, por këto veprime të vendimmarrjes çojnë në prishjen e zgjedhjeve. Si prishen zgjedhjet? Ja pra, me këto akte prishen zgjedhjet. Për sa i përket çfarë u tha tani, dekreti i Presidentit, po këtu kemi qenë nuk ka qenë që kjo sallë se KQZ-ja ishte

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*


e ndryshme në atë kohë ka anuluar dekretin e Presidentit, ka anuluar anulimin e dekretit të Presidentit. Pra, kemi pasur një dekret, doli një shpikje që Presidenti anuloi dekretin e tij kur ishim në mes zgjedhjeve dhe vetë akti i dytë ishte i pavlefshëm dhe këtë qëndrim e mbajti dhe jo vetëm institucioni i KQZ-së. Pra, dekreti i parë i Presidentit është respektuar dhe janë vijuar në zgjedhje. Doli një dekreti i dytë i cili nuk caktonte datë zgjedhje siç jemi në këtë rast konkret, por anulonte datën e zgjedhjeve. Pra, kompetenca e Presidentit është të caktohet datë zgjedhjesh e jo të anulohet datë zgjedhjesh dhe kjo është në thelbin e vendimit të gjykatës të cilën....në atë kohë.

**Z. M. Çakaj:** Thelbi i nderuar, është që KQZ-ja e atëhershme e konsideroi nul dekretin e Presidentit dhe.....

**Znj. I. Nano:** Do t'ju lutesha të dyve zoti Salianji dhe zoti Çakaj edhe një minutë ju lutem e mbyllim këtë debat këtu vazhdojmë me dy kolegët që kanë kërkuar fjalën.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Jam me logjikën, shumë mirë zoti Çakaj, thotë të gjykohet, dekreti i Presidentit, masën e sigurisë, mund të ndodhë dhe kjo, që presim 5 ditë dhe marrim vendimin. Por, për shkak se afatet janë afate të ngutshme dhe afatet janë shumë të afërta, atëherë ju e miratoni aktin sot dhe në qoftë se gjykata merr një vendim për dekretin e Presidentit, ju jeni këtu përsëri dhe normalisht ju do të zbatoni vendimin e gjykatës, por përderisa vendimi i Komisionerit hyn në fuqi menjëherë, dekreti hyn në fuqi menjëherë! Ju jeni të detyruar të vazhdoni procedurën në moment kur të gjykohet sikur dhe një ditë para zgjedhjes të ketë një vendim nga gjykata, patjetër këtu do të jeni dhe ju do të vazhdoni në bazë të vendimit të gjykatës, por nuk mund të thoni, presim afatin e gjykatës. Shumë mirë të premtën ju merrni

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

vendimin, sot të premtën, ka një vendim gjykata po qe se e la në fuqi vendimin e Presidentit vazhdon, po qe se merr një vendim në masë sigurie për atë vendim të Presidentit përsëri është e zgjidhur. Ky akt që merrni ju ngrin, por ju duhet të vazhdoni procedurën. Nuk thuhet në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor që “shiko kur diskutohet një akt në gjykatë ju ndaloni”. Ju nuk ndaloni, ju madje duhet të punoni 24 orë se zgjedhjet janë me afate shumë të afërta. Prandaj ju ftoj dhe një herë që të miratojmë këtë akt dhe pastaj nëse do të ketë veprime të tjera ligjore, atëherë hap pas hapi sikurse ju e thatë, ju jeni këtu për tu mbledhur dhe rimbledhur për të marrë vendimet tuaja.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Salianji! Fjalën e ka zoti Dritan Çaka ka kërkuar fjalën më herët, ndjesë nuk e kam vënë re që keni kërkuar fjalën.

**Z. D. Çaka:** Faleminderit zonja Kryetare e kërkoja fjalën shumë kohë më përpara, pasi zonja Vukaj mori fjalën dhe shprehu mendimet e saj në lidhje me projektaktin. Në radhë të parë unë do të dua të fokusohem në dy pika. Pika e parë është që të justifikoj ose argumentoj më saktë votën time në parim “pro” këtij projektakti të sjellë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Duke theksuar së pari, nuk është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve që na ka iniciuar jo vetëm vendimmarrjen, por gjithë punën tonë si organ i administrimit të zgjedhjeve në këtë moment. Ne na ka detyruar një dekret i Presidentit të Republikës, i cili bazuar në Kodin Zgjedhor na detyron dhe ne më pas të tre organet administruese të procesit zgjedhor që do të marrin vendimet e tyre përkatëse sipas fushës së kompetencës. Mund të mos ishim sot me një propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, por mund të ishte një propozim i secilit prej nesh për këto afate. Duhet theksuar që jemi në një fazë delikate të këtij procesi dhe këto afate janë kaq të ngushta sa që ne jemi gati 25 ditë

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

përpara datës së zgjedhjeve të dekretuara nga Presidenti i Republikës. Ne jemi të detyruar të zbatojmë një dekret i cili në vlerësimin juridik është një dekret në fuqi, i cili ka hyrë në fuqi menjëherë ashtu si dhe çdo vendim tjetër pas tij duhet të bazohet pra, në të. Unë e dëgjova dhe propozimin e kolegut Çakaj që të prisnim të shprehej gjykata duke pasur disa afate procedurale. Unë jam i mendimit se ne duke qenë që kemi afate shumë të ngushta procedurale të cilat duhet t'i miratojmë të vazhdojmë me miratimin sot të këtij akti dhe është mëse normale që nëse gjykata nesër ose pasnesër, pas 5 ditësh po mund të ndodhë dhe pas 10 ditësh, se ne kemi parë që dhe afatet procedurale të gjykatës nuk është se zbatohen gjithnjë. Kështu që ne nuk e dimë se kur gjykata mundet ta marrë në shqyrtim kërkesën e cila në media është bërë publike për pezullimin e dekretit të Presidentit. Kështu që ne kemi ngutshmërinë për t'i miratuar këto afate dhe nëse gjykata do të marrë një vendim kurdo qoftë ai që ta pezullojë dekretin e Presidentit, ne këtu jemi që një orë më pas mund të mblidhemi dhe të marrim veprimet tona procedurale. Por, në qoftë se ne do ta shyjmë atëherë do të jemi të bindur që kjo mund të çojë jo vetëm drejt vështirësive por dhe drejt bllokimit të procesit zgjedhor të datës 4 gusht. Kështu që dhe një herë unë dua të theksoj që ta votojmë sot projektaktin, kuptohet që gjithësecili prej nesh mund të ketë pretendimet e tij në lidhje me afatet të ndryshme procedurale por duhet theksuar që ky është një projektakt i cili nuk është i pari për ne është i treti në këto procese zgjedhore. Duhet theksuar që është i pari me afate më të ngutshme, i pari me afatin më të afërt 30 ditor dhe ndërkohë afatet të cilat janë parashikuar në të, në vlerësimin tim personal janë afate tërësisht jo vetëm të ligjshme, por dhe të logjikshme për t'u zbatuar. Kështu që edhe një herë duke shprehur votën timë "pro" në parim kurdo që do ta shpreh dhe në momentin e votimit, u bëj thirrje të gjithëve ejani ta votojmë një herë dhe më pas nëse do të kemi një vendimmarrje tjetër nga gjykata patjetër që ne do të zbatojmë atë vendim që thotë gjykata. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Çaka! Zonja Vukaj ka kërkuar fjalën.

**Znj. H. Vukaj:** Meqënëse ju zonja Nano si kryetare e seancës nuk e morët inisiativën të respektoni rregulloren tonë në lidhje me rradhën e atyre që duhet të marrin fjalën dhe meqënëse ju e lejuat zotin Salianji, që jo vetëm të kapërcente, por të ndihej i privilegjuar dhe në të njëjtën kohë të merrte guximin të na shantazhonte, në thyerje të etikës dhe integritetit, atëherë unë pavarësisht që ju nuk e bëtë, kërkoj të merren masa ndaj zotit Salianji, e para. E dyta, zoti Salianji me çfarë baze dhe me çfarë roli na përcaktoni kufijtë e shpërdorimit të detyrës dhe kush ju ka autorizuar, cili nen, apo dispozitë ligjore, apo autorizim ligjor që ju të vlerësoni penalisht veprimtarinë tonë, sepse administrativisht apo në çfarë do lloj aspekti tjetër jeni perfekt në të gjitha. Së treti, zoti Salianji përpara se të na adresoni shpërdorim detyre, apo të na kërcënoni më mirë të ishit ndalur tek akti i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili vërtet është shpërdorim detyre, sepse ka marrë kompetencën e Këshillit të Ministrave për të shkarkuar në atë rast të mandatuarin. Ky është shpërdorim detyre zoti Salianji, jo të respektosh ligjin e të kërkosh të ndiqen parimet e të drejtës dhe mjetet e kontrollit të aktit, meqënëse i referoheni Kodit të Procedurës Administrative se çfarë është obligim dhe detyrim ligjor, që një organ detyrimisht t'i përmbahet vlefshmërisë së aktit për përvijimin me procese të tjera dhe në këtë rast nuk e gjejmë zoti Salianji dhe jemi në kushtet e nenit 67, të Kodit të Procedurës Administrative. Më thuaj zoti Salianji, e ju pjesë e administratës, a është respektuar e drejta e ankimit të subjektit? A ka paraqitje ankese nga ana e zotit Beleri, apo të ndonjë të interesuari tjetër? A ka hequr dorë KAS-i apo ka deklaruar në bazë të nenit 133, të Kodit të Procedurës Administrative, pika 3 se ky është një akt i cili do të kalojë për hirin e interesit më të lartë publik, ndonjë interesi tjetër, apo interesit shëndetësor të

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

shtetasve, thotë germa “c” e këtij neni, edhe pa mjetet e ankimit, shfrytëzimin e mjeteve të ankimit. Në qoftë se ekzistojnë këto nuk kemi paraqitje ankimimi brenda 30 ditëve, në qoftë se kemi deklaratë, heqje dorë nga ankimimi, në qoftë se kemi deklaratë nga KAS që e ka verifikuar ligjshmërinë dhe autorizon që të përvijojmë me proceset e tjera për hir se lidhet me interesa të ngutshme, atëherë po, dakord zoti Salianji, vijojmë me procesin dhe bëjmë verifikimin e këtij akti. Nuk jemi në ato kushte zoti Salianji. Ky akt vjen si rrjedhojë e një akti pararendës i cili është në kushtet e shpërdorimit dhe njëherësh pavlefshmërisë, zoti Salianji. Pavlefshmëria absolute është nul që nga fillimi dhe këtë e dimë që në vit të parë të Fakultetit të Drejtësisë. Në këto kushte nuk mund të përvijohet në një proces i cili buron nga një akt i pavlefshëm zoti Salianji, këto besoj se duhet t’i kishit parë në Kodin e Procedurave Administrative para se të vinit, zoti Salianji. Është neni 108, 111 i cili flet për konstatimin e detyrueshëm të aktit aboslutisht të pavlefshëm zoti Salianji dhe këtë e ka të drejtë jo vetëm një anëtar i Komisionit Rregullator që përbën organ dhe shpreh vullnet por çdo shtetas shqiptar kurdoherë për hir të efektit që s’duhet të vijë të atij akti, zoti Salianji. Kështu që vijojmë e nderuar, me vërejtjen që duhet t’i japësh ose masën që duhet t’i japësh përfaqësuesit Salianji.

**Znj. I. Nano:** Pak më herët ju bëra thirrje të gjithëve përfshirë veten, anëtarët e tjerë të Komisionit Rregullator dhe pjesmarrësve në mbledhje për t’u fokusuar në çështjen që kemi në rendin e ditës. Unë në këtë moment mbyll diskutimet në parim. Do t’ju lutesha zoti Salianji, 30 sekonda, jo më tepër... Ke më diskutim në parim, zonja Vukaj?

**Znj. H. Vukaj:** Ju lutem respektoni rregulloren dhe mos e merrni këtë gjë sikur ishte thjesht një fasadë përçuese nga ana e zotit Salianji. Ishte shumë e rëndë ajo që

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

ndodhi, merr masa të lutem! Në qoftë se je ende e denjë për ta vazhduar detyrën e Kryetarit të Komisionit Rregullator... *(nuk dëgjohet)* por nga ana tjetër ke detyrën të mbash rregullin dhe të gjithë këto elementë duhet t'i sheshosh dhe të marrësh masa, e nderuar.

**Znj. I. Nano:** Për t'i sheshuar të gjitha këto që ju thatë zonja Vukaj po pyes dhe një herë, nuk kam pyetur përfaqësuesin e Shoqërisë Civile keni diçka në parim? Jo nuk keni! Anëtarët e Komisionit Rregullator kanë diçka tjetër në parim për projektaktin?

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit e nderuar unë nuk kisha në parim, i bashkohem thirrjes së zonjës Vukaj që ju të respektoni rregulloren. Ju nuk mund të më mbyllni mua mikrofonin dhe të lini përfaqësuesin. E keni shkelur me të katërta këmbët dhe me të gjithë mjetet ligjore e antiligjore sot. Ju keni shkelur rregulloren që kemi hartuar ne. Nëse do të bëjmë debat juridik parimor, jo parimor leri të gjitha palët janë mjete të barabarta diskutimi dhe unë vlerësoj se ajo çfarë përmendi këtu zoti Salianji sot, ishte shumë e rëndë, ishte shantazh i hapur, intimidim përmendja e shpërdorimit të detyrës, ndërkohë që ne jemi në diskrecion të ushtrimit të detyrës sonë. Si thotë Kodi Zgjedhor që ne duhet të votojmë patjetër “pro”, apo duhet të votojmë “kundër”, apo duhet të respektojmë ligjshmërinë. Pse nuk i merrni në konsideratë këto? Nëse ne nuk e vlerësojmë, ose mbajmë qëndrim të kundërt me ju, ne po kryejmë shpërdorim detyre? Më fal po nëse organet e tjera drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë zgjedhur të jenë vegël e partive politike, ose kanë zgjedhur të bëjnë teatër këtu pra, me datë të paracaktuar 4 gusht për datën e zgjedhjeve, e marrin vendimin me datën 5 korrik, ndërkohë që e kishin në tryezë në datën 4 korrik. Unë personalisht refuzoj të kenë këtë qasje për zbatimin e Kodit Zgjedhor. Gjithashtu refuzoj të kem çfarë do lloj presioni, intimidimi, shantazhi nga kushdo përfaqësues i ndonjë subjekti

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

politik. Kështu që edhe unë, ju ftoj e nderuar, së pari të respektoni rregulloren, mos të na hiqni fjalën në mënyrë arbitrare. Së dyti, të merrni masa për atë çfarë deklaroj zoti Salianji këtu, përndryshe e kemi shkelur këtë rregullore, kot që zhvillohen gjithë këto mbledhje. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Çakaj, në momentin që mbylla mikrofonin, e mbylla për ju dhe zotin Salianji, sepse po bëhej një kakofoni dhe ju thashë, ju lutem të dyve! Pastaj vijova me dhënien e fjalës. Zoti Salianji më herët ju përgjigj zotit Çakaj, nëse dëshironi t'i përgjigjeni zonjës Vukaj, sepse ju drejtua do t'ju lutesha shumë shkurt më tej vijoj unë me zbatimin e rregullores.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Ne jemi përfaqësues, jemi me të drejta të plota, ne nuk jemi gazetarë këtu.

**Znj. H. Vukaj:** Zoti Salianji, duhet të marrë masën, pastaj të vijojë mbledhja..


**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj ju drejtuat me pyetje zotit Salianji dhe unë i dhashë fjalën t'ju japë përgjigje.

**Znj. H. Vukaj:** Zoti Salianji nuk e ka të drejtën të më replikojë zonjë.

**Znj. I. Nano:** I dhashë fjalën t'ju japë përgjigje për pyetjet që bëtë.

**Znj. H. Vukaj:** Zonjë nuk kam nevojë të më japë përgjigje zoti Salianji.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

**Znj. I. Nano:** Atëherë mos bëni pyetje në qoftë se nuk ka nevojë të merrni përgjigje. Në qoftë se bëni pyetje, do të merrni përgjigje.

---

**Znj. H. Vukaj:** Zonja Nano më dëgjo, zoti Salianji do të marrë masë, përndryshe kjo mbledhje nuk vijon, merr masa ndaj zotit Salianji.

**Znj. I. Nano:** Çfarë mase propozoni ju lutem në bazë të rregullores?

---

**Znj. H. Vukaj:** Unë propozoj të marrësh masa ashtu siç e etiketon dhe përcakton rregullorja.

**Znj. I. Nano:** Jo pra, ti ma bëj propozimin meqenëse je.. dhe po më tregon rregulloren.


**Znj. H. Vukaj:** Merr masa, pastaj do të vazhdojë kjo mbledhje.

**Znj. I. Nano:** Po zoti Salianji!

---

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Për sa i përket, nuk dua të futem në debat me asnjë prej jush, se personalisht për secilin nga ju kam konsiderata dhe atë çfarë unë thashë në fjalën time, thashë çfarë unë konstatoj dhe si e shoh unë intepretimin e ligjit dhe pasojën që sjell mosmiratimi i këtij akti dhe ndaj doli ai lloj konkluzioni. Për sa i përket rradhës së marrjes së fjalës nga partitë politike, përfaqësuesit sidomos ne që jemi akreditues të përhershëm, kemi të drejtë të barabartë me ju. Rradhën mund ta përcaktoni flisni ju, pastaj flasim ne, por kur flasim ne normalisht nuk jemi gazetarë nuk jemi as nëpunës të KQZ-së, nuk na merr asnjëri në pyetje. Ky kalendari

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

që miratoni është kalendari që janë disa afate që duhet ne të vrapojmë edhe t'i zbatojmë dhe këtu nuk është administratë që jeni mësuar të jepni urdhëra me drejtorë. Partitë politike këtu janë, diskutojnë për aktet, kanë të drejtë të propozojnë e vetmja e drejtë që ju keni është vendimmarrja, normalisht këtu nuk ndërhyjmë. Për sa i përket pjesës tjetër nuk dua të futem më në debat thjesht nuk arrita të kuptoja nga e gjithë logjika e aktit, cili akt është absolutisht i pavlefshëm, dekreti i Presidentit i cili ka vënë në lëvizje këtë akt? Për këtë doja përgjigje.

**Znj. I. Nano:** Kujt ia drejtoni këtë pyetje?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Zonjës Vukaj e cila mbajti të gjithë relatimin që duhet të njohë ligjin, për mua zoti Salianji duhet të njihte procedurën po mi drejtonte mua të gjitha këto dhe se akti është absolutisht i pavlefshëm dhe i konsumuar. Cili akt është i pavlefshëm, dekreti i Presidentit?

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj nëse dëshiron mund të përgjigjesh.

**Znj. H. Vukaj:** Unë marr fjalën në kuadër të zbatimit të nenit 22 të rregullores. Merrni masa ndaj zotit Salianji pastaj do të vijojmë mbledhjen.

**Znj. I. Nano:** Tërhoqa vëmendje unë; kjo është masa që mund të marr.

**Znj. H. Vukaj:** Të largohet nga salla një person që është shprehur në atë shkallë agresiviteti dhe shantazhimi. Nuk mund të shantazhohet asnjë nga anëtarët e Komisionit Rregullator, ju e dini shumë mirë se me çfarë barazohet. Merrni masa pastaj do të vijojë mbledhja.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

**Znj. I. Nano:** Neni 22, pika 3, të rregullores unë e kam përpara dhe unë tërhoqa vëmendjen kjo është masa që mund të marr. Masa tjetër është largimi nga salla për të gjithë personat e pranishëm por është kur prish rregullin. Nuk ka prishur asnjë nga të pranishmit rregullin në sallë.

**Znj. H. Vukaj:** Anëtarët e Komisionit Rregullator me të drejtë vendimmarrëse dhe të shprehin....

**Znj. I. Nano:** Njëllor sikundër ju thatë që ka shpërdoruar detyrën dikush tjetër e kështu me rradhë. Opinione juridike padyshim që mund të japim po gjithmonë duke u fokusuar në atë çfarë kemi në rendin e ditës. Unë tërheqjen e vëmendjes e bëra më herët sipas nenit 22, pika 3 të rregullores.

**Znj. H. Vukaj:** Ajo çfarë shprehu zoti Salianji ishte shumë e rëndë dhe ai duhet të dalë jashtë nga salla. Respekto nenin 22 të rregullores.

**Znj. I. Nano:** Është momenti që të vlerësoj ndryshimin e rregullores. Kemi më diskutime në parim rreth projektaktit? Zonja Vukaj e mora masën tërhoqa vëmendjen sipas..... nuk ka asnjë masë tjetër që unë mund të marr.

**Znj. H. Vukaj:** Ateherë ju jeni e padenjë për të respektuar rregulloren dhe për të bërë detyrën e kryetarit të drejtimit të kësaj trupe.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit për fyerjen, e justifikoj... Deri tani zhvillimi i mbledhjeve mes nesh, pavarësisht debateve nuk ka kaluar kurrë në sulme personale. Ju

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.09.07.2024*

falenderoj, të mbaroj unë një herë, se jam duke folur dhe je duke e shkelur ti rregulloren duke ndërprerë fjalën. Të falenderoj shumë për fyerjen e padenjë. Padenjësia ime, apo denjësia ime nuk vlerësohet nga ju. A ka dikush tjetër për të diskutuar për projektvendimin që kemi për shqyrtim në parim, para se të kalojmë në votim? Nuk ka. Kalojmë në votimin në parim të projektvendimin “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë që do të zhvillohen me datën 4 Gusht 2024”.

***Kush është dakord në parim me projektvendimin?***

***Pro: 3 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela)***

***Kundër: 2 (znj. Vukaj, z. M. Çakaj)***

Projektvendimi nuk miratohet!

Sikundër e dimë, sipas Kodit Zgjedhor ky është një nga projektvendimet që kërkon një shumicë katër me një. Kështu që, zonja Vukaj u lodh kot duke kaluar nen për nen, se nëse projektakti rrëzohet në parim, nuk ka kuptim të kalojmë në votimin nen për nen dhe më pas në tërësi.

***Znj. H. Vukaj: (Nuk dëgjohet) ..... e bëj me shumë vullnet dhe pasion...***

***Znj. I. Nano:*** Patjetër me vullnet, por në kundërshtim me gjithë procedurat për miratimin e një projektakti. Atëherë, duke qenë se projektvendimi nuk miratohet në parim, atëherë nuk mund të vijojmë me shqyrtimin dhe votimin nen për nen të projektvendimin. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit.

**Vendimi nr. 2**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*

